

Ekonomia e eurozonës, sipas të dhënave preliminare, në tremujorin e dytë (TM2) 2018 është karakterizuar me një rritje të ngadalësuar të aktivitetit ekonomik (rreth 2.1 përqind) përderisa inflacioni i është afruar objektivit të BQE-së (1.7 përqind). Përkundër ngadalësimit të rritjes së kërkesës në eurozonë aktiviteti ekonomik në vendet e Ballkanit Perëndimor është karakterizuar me rritje (3.2 përqind në TM1 2018).

Gjatë TM2 2018, çmimet e mallrave bazë në tregjet ndërkombëtare janë rritur kundrejt tremujorit të parë dhe kundrejt tremujorit të njëjtë të vitit 2017, kryesisht si rezultat i tensioneve gjeopolitike të cilat kanë ndikuar në ndryshimin e dinamikave të ofertës dhe kërkesës në treg.

Sipas të dhënave të fundit të Agjencisë së Statistikave të Kosovës (ASK), BPV-ja reale në TM1 2018 shënoi rritje vjetore prej 3.5 përqind, rritje e mbështetur kryesisht nga rritja e investimeve dhe konsumit. Meqenëse të dhënat zyrtare për TM2 2018 nuk janë publikuar ende nga ASK-ja, mbështetur në tregues tjerë me frekuencë më të lartë publikimi, rritja ekonomike në TM2 2018 pritet të jetë më e lartë, kryesisht si rezultat i rritjes së kreditimit, rritjes së remitencave dhe rritjes së shpenzimeve qeveritare.

Gjatë TM2 2018, çmimet e mallrave bazë në tregjet ndërkombëtare kanë vazhduar ecurinë e tyre rritëse me të cilën janë karakterizuar edhe në tremujorët paraprak. Si rezultat, niveli i çmimeve të konsumit në ekonominë e vendit është rritur për 0.8 përqind në

TM2 2018, pas ngadalësimit me të cilin u karakterizuan në TM1 2018. Në anën tjetër, inflacioni bazë (që përjashton ushqimin, energjinë, pijet alkoolike dhe duhanin), në TM2 2018 ishte për 0.3 pikë përqindje më i ulët krahasuar me inflacionin e përgjithshëm dhe qëndroi në 0.5 përqind, kryesisht si rezultat i rënies së çmimit të energjisë.

Spektori fiskal u karakterizua me rritje të të hyrave dhe shpenzimeve buxhetore prej 6.3 përkatësisht 10.3 përqind. Duke pasur parasysh rritjen më të lartë të shpenzimeve buxhetore krahasuar me të hyrat, buxheti i Kosovës deri në qershor 2018 regjistroi deficit primar buxhetor prej 27.1 milionë euro (2.8 milionë euro suficit në periudhën e njëjtë të vitit 2017). Borxhi publik në TM2 2018 ka arritur në 1.03 miliardë euro, që është për 9.2 përqind më i lartë krahasuar me TM2 2017. Rritja e borxhit publik në Kosovë i atribuohet rritjes së borxhit të brendshëm përderisa borxhi i jashtëm publik u karakterizua me rënie.

Deri në maj 2018, sektori i jashtëm është karakterizuar me zvogëlim të deficitit të llogarisë rrjedhëse për 2.2 përqind. Ky përmirësim i deficitit të llogarisë rrjedhëse i atribuohet rritjes së bilanceve pozitive të shërbimeve, të ardhurave parësore dhe dytësore ndërsa deficitit të mallrave shënoi rritje. Në kuadër të bilancit të pagesave, remitencat u karakterizuan me rritje prej 6.5 përqind përderisa Investimet e Huaja Direkte (IHD) shënuan rënie prej 34.0 përqind.

BANKA QENDRORE E REPUBLIKËS SË KOSOVËS  
CENTRALNA BANKA REPUBLIKE KOSOVA  
CENTRAL BANK OF THE REPUBLIC OF KOSOVO

## PËRMBAJTJA

<b>PËRMBLEDHJE</b> -----	<b>i</b>
<b>Eurozona dhe Ballkani Perëndimor</b> -----	<b>03</b>
Çmimet e mallrave bazë në tregjet ndërkombëtare -----	05
<b>Ekonomia e Kosovës</b> -----	<b>06</b>
Sektori Real-----	06
Çmimet-----	08
Regjistri i bizneseve-----	09
Sektori Fiskal-----	10
Sektori i Jashtëm-----	11

## FIGURAT DHE TABELAT

Figura 1. Zhvillimet makroekonomike në eurozonë -----	03
Figura 2. Normat kryesore të interesit në eurozonë-----	04
Figura 3. Çmimi i naftës 'Brent' -----	05
Figura 4. Çmimet e metaleve-----	06
Figura 5. Rritja reale e BPV-së dhe kontribuesit kryesorë-----	06
Figura 6. Konsumi privat dhe burimet e financimit -----	07
Figura 7. Treguesit e tërthortë për investimet private-----	07
Figura 8. Inflacioni i përgjithshëm dhe inflacioni bazë -----	08
Figura 9. Lëvizja e çmimeve të komponentëve kryesorë -----	08
Figura 10. Indekset e çmimeve të konsumit, prodhimit dhe importit -----	08
Figura 11. Lëvizja e çmimeve të importit -----	09
Figura 12. Lëvizja e çmimeve të prodhimit -----	09
Figura 13. Regjistri i bizneseve -----	09
Figura 14. Struktura e ndërmarrjeve të reja-----	10
Figura 15. Eksporti dhe importi i mallrave -----	11
Figura 16. Struktura e eksporteve sipas kategorive-----	12
Figura 17. Struktura e importeve sipas kategorive -----	12
Figura 18. Remitencat-----	13
Figura 19. Struktura e investimeve të huaja direkte sipas komponenteve -----	13
Tabela 1. Rritja reale vjetore e BPV-së -----	04
Tabela 2. Treguesit e zgjedhur makroekonomik -----	15

## SHKURTESAT:


APR	Asetet e Peshuara ndaj Rrezikut
ASK	Agjencia e Statistikave të Kosovës
BPV	Bruto Produkti Vendor
BQK	Banka Qendrore e Republikës së Kosovës
EJL	Evropa Juglindore
EUR	Valuta Euro
FMN	Fondi Monetar Ndërkombëtar
IÇK	Indeksi i Çmimeve të Konsumit
IHD	Investimet Huaja Direkte
IPI	Indeksi i Çmimit të Importit
KMA	Kthimi Mesatar në Asete
KMK	Kthimi Mesatar në Kapital
MF	Ministria e Financave e Republikës së Kosovës
NRER	Norma Reale Efektive e Këmbimit
TMK	Treguesit e Mjaftueshmërisë së Kapitalit
WEO	World Economic Outlook

### Eurozona dhe Ballkani Perëndimor

Sipas të dhënave preliminare të Agjencisë Statistikore të Bashkimit Evropian (Eurostat), në TM2 2018 ekonomia e eurozonës shënoi rritje vjetore prej 2.1 përqind, që është një normë e rritjes më e ngadalësuar krahasuar me tremujorin paraprak si dhe tremujorin e njëjtë të vitit të kaluar (2.5 përqind rritje në të dy tremujorët) (figura 1). Ky ngadalësim i aktivitetit ekonomik pjesërisht mund të shpjegohet nga disa faktorë të përkohshëm, duke përfshirë kushtet e këqija atmosferike, grevat në disa vende të eurozonës, por edhe si rezultat i ritmit shumë të fortë të rritjes në vitin 2017. Pritjet për ecurinë e aktivitetit ekonomik në eurozonë për tremujorët e tjerë të vitit 2018 janë optimiste, në përputhje me nivelet ende të larta të indekseve të besueshmërisë së bizneseve dhe të individëve. Sipas projeksioneve të Bankës Qendrore Evropiane (BQE), eurozona pritët të shënojë rritje ekonomike prej 2.1 përqind në vitin 2018, rritje e cila pritët të ngadalësohet gradualisht në tre vitet e ardhshme (1.7 përqind në 2020). Qëndrueshmëria e rritjes ekonomike në eurozonë mund potencialisht të rrezikohet në periudhat në vazhdim në rast të zbatimit të tarifave më të larta tregtare, mundësisë së masave më të gjera proteksioniste dhe shtrëngimit të kushteve të financimit.


Përderisa fillimi i vitit 2018 u karakterizua me presione të dobëta inflacioniste, zhvillimet e përgjithshme të çmimeve në eurozonë në muajt në vazhdim kanë shfaqë tendencë rritjeje, ku shkalla e inflacionit arriti objektivin e BQE-së prej 2 përqind në qershor 2018. Në TM2 2018, mesatarja e Indeksit të Harmonizuar të Çmimeve të Konsumit në eurozonë ishte 1.7 përqind (figura 1) dhe kontributi më i lartë

në normën vjetore të inflacionit erdhi nga shërbimet (+0.58 pikë përqindje), pasuar nga energjia (+0.53 pikë përqindje), dhe ushqimi, alkooli e duhani (+0.50 pikë përqindje).



Në qershor të vitit 2018, Këshilli Mbikëqyrës i BQE-së ka konfirmuar se programi për blerjen e aseteve në vlerë prej 30 miliardë euro do të vazhdoj deri në fund të shtatorit 2018 dhe më pas, varësisht nga zhvillimet në nivelin e çmimeve, blerja e aseteve do të reduktohet në 15 miliardë euro deri në fund të dhjetorit 2018. Gjithashtu, Këshilli Mbikëqyrës vendosi t'i mbajë të pandryshuar normën e interesit të operacioneve kryesore të refinancimit (0.0 përqind), normën e interesit mbi lehtësirat kreditore (0.25 përqind) dhe depozitare (-0.40 përqind). BQE-ja pritët të vazhdojë të mbajë normën e interesit në operacionet kryesore të refinancimit të pandryshuar edhe pas përfundimit të programit të lehtësimit sasior. Normat e kreditimit ndër-bankar Euribor 1 muajor dhe 12 muajor vazhdojnë të jenë në territor negativ (-0.37 përqind përkatësisht -0.18 përqind), ndërsa yield-i i obligacioneve qeveritare dhjetëvjeçare të eurozonës ka shënuar një rritje të lehtë gjatë TM2 2018, duke arritur në 1.29 përqind (figura 2).

Figura 2. Normat kryesore të interesit në eurozonë



Burimi: BQE (2018)

Aktiviteti kreditues në eurozonë ka shënuar përmirësim të lehtë në TM2 2018. Kjo rritje ka ardhur si rezultat i rritjes së kredive akorduar ekonomive familjare por edhe ndërmarrjeve. Kreditë ndaj ekonomive familjare shënuan rritje prej 2.9 përqind ndërsa kreditë ndaj ndërmarrjeve shënuan rritje prej 2.6 përqind. Ngjashëm me ecurinë e kreditimit, janë zhvilluar edhe dinamikat e depozitave në sistemin bankar. Në TM2 2018, depozitat e ndërmarrjeve shënuan rritje prej 5.4 përqind ndërsa depozitat e ekonomive familjare shënuan rritje prej 3.9 përqind.

Aktiviteti ekonomik në vendet e Ballkanit Perëndimor gjatë TM1 2018<sup>1</sup> ka shënuar rritje prej mesatarisht 3.2 përqind (1.3 përqind në TM1 2017). Serbia, Mali i Zi dhe Shqipëria shënuan rritje më të lartë (rreth 4.5 përqind secila), pasuar nga Kosova dhe Bosnja e Hercegovina me 3.5 përqind përkatësisht 2.0 përqind. Përmirësimi i aktivitetit ekonomik në këto vende është udhëhequr kryesisht nga performanca e mirë e sektorit të ndërtimit, tregtisë dhe industrisë. Ndryshe nga ekonomitë e vendeve tjera të Ballkanit Perëndimorë, ekonomia e Maqedonisë nuk arriti që të

shënoi përmirësim të aktivitetit ekonomik gjatë TM1 2018, mirëpo tejkalimi i ngërçit të tej zgjatur politik pritet të kontribuoj në reduktimin e pasigurive për të ardhmen dhe rrjedhimisht në rritjen e aktivitetit ekonomik gjatë vitit 2018.

Tabela 1. Rritja reale vjetore e BPV-së

Përshkrimi	2016	2017	2017 TM1	2017 TM2	2017 TM3	2017 TM4	2018 TM1
Bosnja dhe Hercegovina	3.0	1.2	-2.7	1.0	6.1	0.5	2.0
Kosova	4.1	3.7	2.8	4.4	4.4	3.2	3.5
Mali i Zi	2.9	4.2	2.9	5.0	4.8	3.9	4.5
Maqedonia	2.9	0.0	0.0	-1.3	0.2	1.2	0.1
Serbia	2.8	1.9	1.1	1.6	2.3	2.4	4.6
Shqipëria	3.4	3.8	3.9	4.3	3.5	3.6	4.5

Burimi: Zyrat Kombëtare Statistike të vendeve përkatëse

Në TM2 2018, inflacioni në vendet e Ballkanit Perëndimor ka shënuar normë mesatare prej 1.6 përqind (2.2 përqind në TM2 2017). Këto presione më të dobëta inflacioniste ishin kryesisht në Maqedoni (0.3 përqind), Kosovë (0.7 përqind), Bosnje e Hercegovinë (1.2 përqind) dhe Serbi (1.8 përqind), ndërsa në Mal të Zi dhe Shqipëri normat e inflacionit ishin më të larta krahasuar me vendet tjera por edhe krahasuar me TM2 2017. Në Mal të Zi norma mesatare e inflacionit ishte 3.7 përqind (2.5 përqind në TM2 2017), për shkak të rritjes së çmimeve të energjisë dhe të një sërë tatimesh në kuadër të rregullimit fiskal. Në Shqipëri, inflacioni mesatar në TM2 2018 shënoi vlerën prej 2.2 përqind (2.0 përqind në TM2 2017). Presionet e brendshme pozitive mbi inflacion, gjatë këtij tremujori, janë balancuar nga mbiçmimi i fortë i kursit të këmbimit.

Sa i përket zhvillimeve në sektorin bankar, rritja e kredive dhe depozitave ishte e konsiderueshme dhe me diferenca të theksuara ndërmjet vendeve. Deri në qershor të vitit 2018 norma mesatare e rritjes së kredive ishte 6.7 përqind (4.9 përqind deri në qershor

<sup>1</sup> Të dhënat për TM2 2018 nuk janë publikuar ende.

2017). Vendet të cilat shënuan rritje më të lartë kreditimit ishin Mali i Zi dhe Kosova (13.0 përqind përkatësisht 11.3 përqind) ndërsa Serbia dhe Maqedonia shënuan rritje më të ulët (3.9 përqind përkatësisht 5.3 përqind). Depozitat shënuan normë edhe më të lartë të rritjes krahasuar me kreditë. Deri në qershor 2018, norma mesatare e rritjes së depozitave ishte 10.9 përqind (7.2 përqind deri në qershor 2017). Edhe tek depozitat, norma më e lartë e rritjes është shënuar në Mal të Zi (15.2 përqind), pasuar nga Serbia me 11.0 përqind, Maqedonia me 9.8 përqind, etj.

Gjatë TM2 2018, euro është vlerësuar ndaj lirës turke me 32.5 përqind, dollarit amerikan dhe frankës zvicerane me 8.4 përqind secila dhe sterlinës britaneze me 1.8 përqind, ndërsa ndaj lekut shqiptar dhe dinarit serb, monedha euro është zhvlerësuar me rreth 5.2 përqind dhe 3.9 përqind, respektivisht.


### **Çmimet e mallrave bazë në tregjet ndërkombëtare**

Gjatë TM2 2018, çmimet e mallrave bazë në tregjet ndërkombëtare janë rritur krahasuar me tremujorin paraprak dhe me TM2 2017, si rezultat i tensioneve gjeopolitike të cilat kanë ndikuar në ndryshimin e dinamikave të ofertës dhe kërkesës në treg.

Çmimi i naftës së papërpunuar shënoi rritje prej 10.7 përqind krahasuar me tremujorin paraprak, ndërsa krahasuar me TM2 2017 rritja ishte edhe më e lartë (47.5 përqind). Çmimi i naftës *Brent* shënoi vlerën mesatare prej 74.1 dollarë për fuçi në TM2 2018 (50.2 dollarë për fuçi në TM2 2017). Në këtë rritje të çmimit të naftës ndikuan një sërë faktorësh, të cilët kanë rrezikuar eksportin e tij: zvogëlimi i stoqeve si rezultat i rritjes së kërkesës botërore, marrëveshja e

vendeve të OPEC-ut për të reduktuar ofertën e naftës, tensionet gjeopolitike në vendet e Lindjes së Mesme, etj. Gjatë vitit 2018, çmimet e naftës së papërpunuar pritët të luhaten mesatarisht rreth vlerës 65 dollarë për fuçi. Megjithatë, ecuria e çmimeve të naftës në të ardhmen varet në mënyrë të konsiderueshme nga balanca ndërmjet prodhimit të naftës në SHBA dhe vazhdimësisë në uljen e prodhimit të naftës nga OPEC-u (figura 3).

Figura 3. Çmimi i naftës 'Brent'




Burimi: Banka Botërore (2018)

Çmimet e metaleve dhe mineraleve shënuan rritje prej 19.2 përqind krahasuar me TM2 2017, ndërsa krahasuar me tremujorin paraprak shënuan rënie prej 0.7 përqind. Kjo rënie e çmimeve është rezultat i reduktimit të kërkesës në sektorët e infrastrukturës, prodhimit dhe pasurisë së patundshme në ekonominë e Kinës. Edhe për pjesën tjetër të vitit, rritja e çmimeve të metalit pritët të ngadalësohet. Për shkak të ofertës së lartë, çmimi i metalit të hekurti pritët të shënoi rënie prej 11 përqind, i cili pritët të kompensohet nga rritja e çmimeve të metaleve tjera kryesore, veçanërisht e nikelit. Gjithashtu, në të ardhmen ekonomia e Kinës do të luajë një rol shumë të rëndësishëm në tregjet globale të metaleve, duke qenë se përbën rreth 50% të konsumit të metaleve në

nivel global. Kina pritet të reformojë procesin e sektorit të minierave dhe të përpunimit dhe të orientohet drejt një ekonomie të bazuar në konsum, gjë e cila do të ndikojë në rritje më të ngadaltë të kërkesës për metale (figura 4).

Figura 4. Çmimet e Metaleve



Burimi: Banka Botërore (2018)

Edhe çmimi i arit ka shënuar rritje vjetore prej rreth 4.9 përqind në TM2 2018, duke regjistruar vlerën 1,319.1 dollarë për ons. Kjo rritje i atribuohet kërkesës më të fortë për investim në kushtet e dobësimit të dollarit dhe rritjes së inflacionit. Edhe pse shtrëngimi i politikës monetare nga Rezerva Federale pritet të reduktojë kërkesën për investime për asetet që nuk kanë kthim (siç është rasti i arit), rritja e normës bazë së interesit nuk pati ndonjë ndikim në çmimin e arit. Gjatë vitit 2018, çmimi i arit pritet të rritet me rreth 3.3 përqind, si rezultat i rritjes së kërkesës për investim.

Në TM2 2018, indeksi i çmimeve të ushqimit shënoi rritje prej 6.5 përqind krahasuar me TM2 2017, si rezultat i mbjelljeve të reduktuara të misrit dhe prodhimit të kufizuar në Amerikën Jugore për shkak të kushteve klimatike. Gjatë vitit 2018 dhe në vazhdim, çmimet e ushqimeve priten të stabilizohen,


me një tendencë të lehtë rritëse si pasojë e shtrëngimit së ofertës së tyre.

## Ekonomia e Kosovës

### Sektori Real

Sipas të dhënave të Agjencisë së Statistikave të Kosovës (ASK), BPV-ja reale në TM1 2018 shënoi rritje vjetore prej 3.5 përqind. Kontributi kryesor në këtë rritje ka ardhur nga investimet me 2.5 pikë përqindje, ndërsa konsumi ka kontribuar me 2.1 pikë përqindje. Në anë tjetër, eksportet neto, si rezultat i rritjes së theksuar të importit, kanë ndikuar negativisht në rritjen e BPV-së me 1.1 pikë përqindje (figura 5).

Figura 5. Rritja reale e BPV-së dhe kontribuesit kryesorë




Burimi: ASK (2018) dhe llogaritjet e BQK-së

Kontributi pozitiv i investimeve totale i atribuohet kryesisht investimeve publike, pasi që shpenzimet kapitale të qeverisë shënuan rritje prej 44.0 përqind në TM1 2018. Konsumi privat ka kontribuar me 1.3 pikë përqindje (2.8 pikë përqindje në TM1 2017). Ky kontribut pozitiv mbështetet nga zhvillimet pozitive që janë regjistruar në burimet kryesore të financimit të konsumit privat. Kredia e re për konsum, kompensimi i punëtorëve dhe remitencat kanë



përshpejtuar trendin e rritjes, duke shënuar rritje vjetore prej 52.0, 16.0 përkatësisht 4.2 përqind në TM1 2018. Ndërkohë vlera më e ulët e kontributit të konsumit privat në TM1 2018 krahasuar me TM1 2017 i atribuohet kryesisht rritjes më të ngadaltë të importit të mallrave të konsumit i cili shënoi rritje prej 1.7 përqind (5.7 përqind në TM1 2017) (figura 6). Përveç konsumit privat edhe konsumi publik, si rezultat i rritjes së shpenzimeve rrjedhëse prej 8.6 përqind, kontribuoi pozitivisht në rritjen e BPV-së reale (0.8 pikë përqindje).

Figura 6. Konsumi privat dhe burimet e financimit



Burimi: ASK (2018) dhe llogaritje të BQK-së


Sipas metodës së prodhimit, kontributin më të madh në rritjen e BPV-së reale në TM1 2018 e kishte tregtia dhe ndërtimtaria (0.6 pikë përqindje secila), aktivitetet financiare dhe industria përpunuese (0.4 pikë përqindje secila), etj. Ndërsa, industria nxjerrëse pati kontribut negativ (0.4 pikë përqindje) në rritjen e BPV-së reale.

Edhe pse të dhënat zyrtare nga ASK-ja për BPV-në reale në TM2 2018 nuk janë publikuar ende, mbështetur në tregues tjerë me frekuencë më të lartë publikimi, rritja ekonomike në këtë tremujor kundrejt tremujorit paraprak pritët të jetë më e lartë, kryesisht

si rezultat i përmirësimit të ecurisë së konsumit dhe investimeve.

Për sa i përket ecurisë së konsumit, burimet kryesore të financimit japin sinjale pozitive (figura 6). Kredia e re për konsum dhe shpenzimet rrjedhëse janë rritur për 16.8 përqind përkatësisht për 7.2 përqind në TM2 2018. Gjithashtu, remitencat dhe kompensimi i punëtorëve janë rritur për 9.5 përqind përkatësisht 10.4 përqind në muajt prill-maj 2018. Sinjal tjetër i rritjes së konsumit është rritja e importit të mallrave të konsumit prej 5.8 përqind në TM2 2018. Edhe treguesit e tërthortë për investimet private ofrojnë sinjale pozitive në TM2 2018. Kreditë e reja për investime si dhe importi i mallrave kapitale kanë shënuar rritje prej 28.7 përqind përkatësisht 24.8 përqind. Gjithashtu, numri i bizneseve të reja, korrigjuar me numrin e bizneseve të mbyllura, ka regjistruar rritje prej 24.4 përqind në TM2 2018. Në anën tjetër, eksportet neto janë përkeqësuar në TM2 2018, duke zgjeruar bilancin e tyre negativ me rreth 12.2% përqind.

Figura 7. Treguesit e tërthortë për investimet private



Burimi: ASK (2018) dhe llogaritje të BQK-së

Sipas projeksioneve të BQK-së, aktiviteti ekonomik gjatë vitit 2018 do të shënojë një përmirësim të lehtë




krahasuar me të dhënat aktuale të vitit 2017, duke u luhatur në një interval prej 4.2 përqind në 4.4 përqind. Ky përmirësim i lehtë i atribuohet kryesisht stimulit të përforcuar fiskal, rritjes së kreditimit dhe remitencave gjatë vitit 2018, të cilat pritet të vazhdojnë të jenë burime të qëndrueshme për financimin e aktivitetit ekonomik.

### Çmimet

Indeksi i çmimeve të konsumit, i cili gjatë TM1 2018 mbeti i pandryshuar, në TM2 2018 ka filluar të shënoi rritje. Norma mesatare inflacionit në TM2 2018 ishte 0.8 përqind (figura 8).


Figura 8. Inflacioni i përgjithshëm dhe inflacioni bazë, ndryshimi vjetor në përqindje



Burimi: ASK dhe kalkulimet e BQK-së (2018)

Sa i përket komponentëve të IÇK-së, gjatë TM2 2018, me rritje u karakterizuan çmimet e transportit (3.3 përqind), pasuar nga çmimet e pijeve alkoolike dhe duhanit (2.4 përqind), çmimet e restoranteve dhe hoteleve (1.4 përqind), çmimet e ushqimit dhe pijeve jo-alkoolike (0.5 përqind), etj. Në anën tjetër, rënie e çmimeve është shënuar tek çmimet rekreacionit dhe kulturës (1.5 përqind), çmimet e mjeteve të komunikimit (1.2 përqind), çmimet e veshmbathjes (0.6 përqind), çmimet e rrymës, gazit dhe lëndëve tjera djegëse (0.6 përqind), etj. (figura 9).


Figura 9. Lëvizja e çmimeve të komponentëve kryesorë, ndryshimi vjetor në përqindje



Burimi: ASK (2018)

Meqenëse shporta e konsumatorit kosovarë karakterizohet me pjesëmarrje shumë të lartë të produkteve me lëvizje sezonale të çmimeve (ushqimi, energjia, pijet alkoolike dhe duhani), atëherë edhe inflacioni bazë, i cili përjashton këto komponente, është më stabil (figura 9). Një gjë e tillë është vërejtur edhe në TM2 2018 ku inflacioni bazë prej 0.5 përqind ishte për 0.3 pikë përqindje më i ulët se sa inflacioni i përgjithshëm.

Figura 10. Indekset e çmimeve të konsumit, prodhimit dhe importit




Burimi: ASK (2018)

Si pasojë e varësisë së lartë të ekonomisë së Kosovës nga importi, dinamika e lëvizjes së çmimeve në Kosovë ndikohet në masë të madhe edhe nga lëvizja e

çmimeve të importit. Indeksi i çmimeve të importit në TM1 2018 shënoi rritje prej 1.4 përqind (figura 10).

Çmimet e metaleve bazë, tekstilit dhe produkteve bimore, të cilat janë kategoritë kryesore të indeksit të çmimeve të importit, shënuan rritjen më të lartë (12.3 përqind, 6.1 përqind, përkatësisht 4.8 përqind), ndërsa çmimet e lëkurës si dhe çmimet e letrës dhe artikujt e saj shënuan rënien më të lartë (10.5 përqind përkatësisht 6.2 përqind) (figura 11).


Figura 11. Lëvizja e çmimeve të importit, ndryshimi vjetor në përqindje



Burimi: ASK (2018)

Indeksi i çmimeve të prodhimit në TM1 2018 u karakterizua me rritje vjetore prej 0.2 përqind.

Figura 12. Lëvizja e çmimeve të prodhimit, ndryshimi vjetor në përqindje




Burimi: ASK (2018)

Në këtë periudhë, me rritje të çmimeve u karakterizuan prodhimi i pajisjeve elektrike, prodhimi i drurit, prodhimi i metaleve (14.8 përqind, 4.7 përqind, përkatësisht 2.5 përqind), ndërsa me rënie të çmimeve u karakterizuan kryesisht nxjerrja e xehes së metalit, energjia elektrike, prodhimi i mobileve (2.8 përqind, 1.4 përqind, përkatësisht 0.5 përqind) (figura 12).

### Regjistri i Bizneseve

Tregues i rëndësishëm i zhvillimeve në sektorin real është edhe numri i bizneseve të reja të regjistruara. Për dallim nga viti 2017 dhe TM1 2018 që ishin karakterizuar me numër më të vogël të ndërmarrjeve të regjistruara, në TM2 2018 është shënuar trend rritës.

Figura 13. Regjistri i bizneseve, jo kumulative




Burimi: ASK (2018)

Janë regjistruar rreth 2,636 ndërmarrje vetëm në TM2 2018 apo 399 ndërmarrje më shumë krahasuar me TM2 2017. Përveç kësaj, në TM2 2018 janë mbyllur 407 ndërmarrje apo 38 ndërmarrje më pak krahasuar me TM2 2017 (figura 13).

Aktiviteti ekonomik më i preferuar vazhdon të jenë sektori i tregtisë ku u regjistruan 723 ndërmarrje të

reja apo 16.1 përqind më shumë krahasuar me TM2 2017, ndërsa është inkurajuese rritja e numrit të ndërmarrjeve tek sektori i bujqësisë dhe sektori i prodhimit. Në sektorin e bujqësisë u regjistruan 198 ndërmarrje të reja apo dyfish më shumë krahasuar me TM2 2017 ndërsa në sektorin e prodhimit u regjistruan 299 ndërmarrje të reja apo 27.8 përqind më shumë krahasuar me TM2 2017. Rritje e konsiderueshme e numrit të ndërmarrjeve të regjistruara është shënuar edhe në sektorin e ndërtimitarisë me 260 ndërmarrje apo 28.7 përqind më shumë krahasuar me TM2 2017, etj. (figura 14).

Figura 14. Struktura e ndërmarrjeve të reja



### Sektori Fiskal

Deri në qershor 2018, sektori fiskal u karakterizua me performancës të mirë të të hyrave buxhetore dhe rritje të shpenzimeve buxhetore. Rritja e shpenzimeve ishte më e lartë krahasuar me të hyrat dhe rrjedhimisht buxheti i Kosovës regjistroi deficit primar buxhetor i cili arriti në 27.1 milionë euro (2.8 milionë euro suficit në gjysmën e parë të vitit 2017).

Të hyrat buxhetore<sup>2</sup> arritën vlerën prej 801.3 milionë euro apo 6.3 përqind më shumë krahasuar me periudhën e njëjtë të vitit të kaluar. Rritja e arkëtimit të të hyrave buxhetore erdhi si rezultat i rritjes së aktivitetit ekonomik por edhe reformave të ndërmarra nga agjencitë e të hyrave që kanë për synim ngushtimin e hendekut tatimor. Sa i përket llojit të tatimeve, vërehet rritje më e lartë e të hyrave tatimore direkte të cilat arkëtohen nga tatimet në të ardhura dhe pasuri. Këto të hyra shënuan rritje prej 20.8 përqind dhe arritën vlerën 143.8 milionë euro. Me rritje u karakterizuan edhe të hyrat tatimore indirekte të cilat janë të ndërlidhura me lëvizjen e importit i cili ka shënuar rritje të konsiderueshme. Të hyrat indirekte arritën vlerën prej 600.6 milionë euro (4.7 përqind rritje). Në anën tjetër, të hyrat jo-tatimore, që kryesisht janë të hyra nga organizatat buxhetore, shënuan rënie prej 5.4 përqind dhe arritën vlerën 86.0 milionë euro.

Ndërkaq, sa i përket shpenzimeve buxhetore<sup>3</sup>, ato arritën vlerën prej 828.4 milionë euro që paraqet një rritje vjetore prej 10.3 përqind. Gjatë kësaj periudhe të gjitha kategoritë e shpenzimeve buxhetore u karakterizuan me rritje. Rritja më e lartë është shënuar tek shpenzimet kapitale të cilat arritën vlerën prej 183.1 milionë euro apo 14.9 përqind më shumë krahasuar me gjysmën e parë të vitit 2017. Përveç kësaj, është vërejtur edhe një nivel më i lartë i realizimit të shpenzimeve kapitale i cili ka arritur në 33.5 përqind (32.0 përqind në gjysmën e parë të vitit 2017). Shpenzimet qeveritare për mallra dhe

<sup>2</sup> Në kuadër të të hyrave buxhetore nuk përfshihen të hyrat nga huamarrjet, të hyrat nga privatizimi, pranimet nga grantet e përcaktuara të donatorëve dhe pranimet nga depozitat në mirëbesim.

<sup>3</sup> Në kuadër të shpenzimeve buxhetore nuk përfshihen pagesat e borxhit, pagesat për anëtarësim në IFN dhe kthimet nga fondet e depozitave.

shërbime (përfshihen edhe komunalitetë) shënuan rritje për 10.0 përqind dhe arritën vlerën prej 104.4 milionë euro. Subvencionet dhe transferet shënuan rritje për 9.8 përqind dhe arritën vlerën prej 253.6 milionë euro. Kategoria e pagave që përbën kategorinë kryesore të shpenzimeve buxhetore (35.5 përqind e gjithsej shpenzimeve), shënoi rritje prej 7.2 përqind dhe arriti vlerën 293.8 milionë euro.

Borxhi publik, në TM2 2018, ka arritur në 1.03 miliardë euro që është për 9.2 përqind më i lartë krahasuar me TM2 2017. Rritja e borxhit publik në Kosovë i atribuohet rritjes së borxhit të brendshëm publik prej 22.2 përqind (i cili ka arritur në 616.8 milionë euro), ndërsa borxhi i jashtëm publik ka shënuar rënie prej 5.6 përqind dhe ka arritur në 418.4 milionë euro. Pra, pjesa më e madhe e borxhit publik (59.6 përqind) është borxh i brendshëm, që kryesisht përbëhet nga borxhi i Qeverisë së Kosovës ndaj bankave komerciale (41 përqind), fondeve pensionale (25 përqind), etj. Pjesa tjetër e borxhit publik (40.4 përqind) është borxh i jashtëm, që kryesisht i përket Fondi Monetar Ndërkombëtar me 39 përqind, Bankës Ndërkombëtare për Rindërtim dhe Zhvillim me 37 përqind, Agjencisë Gjermane për Rindërtim me 12 përqind, etj.


Si përqindje e BPV-së, borxhi publik ka arritur në 16.3 përqind nga 15.5 përqind sa ishte në TM2 2017. Përkundër rritjes, ky nivel i borxhit është ende larg pragut prej 40 përqind të paraparë me ligj. Për më tepër, ky nivel i borxhit publik e mbanë Kosovën në pozitën e vendit me shkallën më të ulët të borxhit publik krahasuar me vendet e rajonit, të cilat sipas FMN-së, kanë një mesatare të borxhit publik prej 59.1 përqind.

### Sektori i Jashtëm

Deri në maj 2018, sektori i jashtëm është karakterizuar me zvogëlim të deficitit të llogarisë rrjedhëse për 2.2 përqind krahasuar me periudhën e njëjtë të vitit të kaluar. Ky përmirësim i deficitit të llogarisë rrjedhëse i atribuohet rritjes së bilanceve pozitive të shërbimeve, të ardhurave parësore dhe dytësore ndërsa deficiti i mallrave shënoi rritje.

Deficiti në llogarinë e mallrave shënoi vlerën prej 791.2 milionë euro në TM2 2018, që paraqet një rritje vjetore prej 15.7 përqind. Përderisa në vitin 2017 ishte shënuar rritje e theksuar e eksportit të mallrave, viti 2018 ka filluar me trend negativ.

Figura 15. Eksporti dhe importi i mallrave, në milionë euro




Burimi: ASK(2018)

Në TM2 2018 eksportit i mallrave ka shënuar vlerën prej 95.5 milionë euro që është për 7.2 përqind më pak krahasuar me TM2 2017 (figura 15).<sup>4</sup> Kjo rënie e eksportit të mallrave ishte për shkak të ngadalësimit të rritjes së çmimeve në tregjet ndërkombëtare por edhe për shkak të stabilizimit të kërkesës së jashtme.

<sup>4</sup> Burimi i të dhënave për eksportin dhe importin e mallrave në Kosovë është Agjencia e Statistikave të Kosovës.

Figura 16. Struktura e eksporteve sipas kategorive, në përqindje



Burimi: ASK (2018)


Rënia e eksportit të mallrave gjatë këtij tremujori ishte më e theksuar tek metalet bazë dhe produktet minerale. Në anën tjetër, rritje të lehtë shënoi eksporti i produkteve të plastikës dhe gomës, eksporti i makinerive dhe materialeve elektrike, eksporti i tekstilit dhe artikujve të tekstilit, etj. (figura 16).

Si rezultat i rritjes së kërkesës së brendshme në vend, me rritje të konsiderueshme është karakterizuar importi i mallrave. Vlera e importit të mallrave në TM2 2018 ishte 886.7 milionë euro, që është për 12.7 përqind më shumë krahasuar me TM2 2017. Rritje e importit të mallrave u shënuar pothuajse tek të gjitha kategoritë, mirëpo rritja më e lartë u shënuar tek importi i makinerive dhe materialeve elektrike, metaleve bazë, produkteve minerale, etj. (figura 17). Si rezultat i rritjes shumë të lartë të importit të mallrave dhe rënies së eksportit, shkalla e mbulueshmërisë së importeve me eksporte ka rënë në 10.8 përqind në TM2 2018 nga 12.6 përqind sa ishte në TM2 2017.

Bilanci në tregtinë e shërbimeve shënoi vlerën prej 127.7 milionë euro deri në maj 2018, një rritje prej 20.4 përqind krahasuar me periudhën e njëjtë të vitit

2017. Vlera e gjithsej shërbimeve të eksportuara shënoi rritje vjetore prej 19.0 përqind, duke arritur në 334.8 milionë euro, ndërsa vlera e shërbimeve të importuara shënoi rritje prej 18.2 përqind dhe arriti në 207.1 milionë euro.

Figura 17. Struktura e importeve sipas kategorive, në përqindje



Burimi: ASK (2018)


Në kuadër të eksportit të shërbimeve, shërbimet e udhëtimit, që përbëjnë kategorinë kryesore të eksportit (65.6 përqind), shënuan rritje prej 13.9 përqind. Sa i përket importit të shërbimeve, shërbimet e biznesit dhe shërbimet e udhëtimit shënuan rritjen më të lartë, ndërsa shërbimet kompjuterike, informative dhe të telekomunikacionit shënuan rënie.

Bilanci i llogarisë së të ardhurave parësore, deri në maj 2018, shënoi vlerën prej 53.4 milionë euro (22.7 milionë euro në periudhën e njëjtë të vitit 2017). Bilanci i të ardhurave nga kompensimi i punonjësve<sup>5</sup> shënoi rritje për 10.4 përqind, ndërsa bilanci i të ardhurave nga investimet u zvogëlua për 35.6 përqind. Në të njëjtën periudhë, bilanci i të ardhurave dytësore shënoi rritje për 11.6 përqind, që i atribuohet

<sup>5</sup> Kompensimi i punonjësve përfshinë pagat, mëditjet dhe beneficionet e tjera të pranuar nga punëtorët rezident jashtë vendit. Në këtë kontekst, përfshinë punëtorët sezonal apo punëtorët tjerë afatshkurtër (më pak se një vit) dhe punëtorët kufitar të cilët qëndrën e interesit ekonomik e kanë në ekonominë e tyre.

nivelit më të lartë të remitencave. Remitencat e pranuar në Kosovë, që njëherësh paraqesin edhe kategorinë më të madhe në kuadër të llogarisë së të ardhurave dytësore arritën vlerën prej 307.8 milionë euro dhe shënuan një rritje vjetore prej 6.5 përqind (figura 18).

Figura 18. Remitencat, në milionë euro




Burimi: BQK (2018)

Remitencat që pranohen në Kosovë kryesisht vijnë nga Gjermania dhe Zvicra, vende këto nga të cilat dërgohen 39.8 përkatësisht 21.5 përqind e gjithsej remitencave. Një pjesë e konsiderueshme e remitencave është pranuar edhe nga SHBA-të, gjegjësisht 6.4 përqind e gjithsej remitencave të pranuar në Kosovë. Llogaria financiare deri në maj 2018 shënoi bilanc prej -138.9 milionë euro (-184.0 milionë euro në periudhën e njëjtë të vitit 2017).

Detyrimet por edhe asetet shënuan nivel dukshëm më të ulët krahasuar me periudhën e njëjtë të vitit 2017. Detyrimet shënuan vlerën prej 111.5 milionë euro (266.5 milionë euro në periudhën e njëjtë të vitit 2017) ndërsa asetet shënuan vlerën prej -27.4 milionë euro (82.5 milionë euro në periudhën e njëjtë të vitit 2017).

Figura 19. Struktura e investimeve të huaja direkte sipas komponenteve, në milionë euro



Burimi: BQK (2018)

Në kuadër të detyrimeve, kategoria kryesore janë IHD-të, të cilat arritën vlerën prej 76.0 milionë euro dhe shënuan rënie vjetore prej 34.0 përqind. Në kuadër të strukturës së IHD-ve, me rënie u karakterizua kapitali dhe fondi i investimeve në aksione si dhe investimet në instrumente të borxhit (figura 19).

Kapitali dhe fondi i investimeve në aksione arriti vlerën prej 94.8 milionë euro dhe shënoi rënie prej 3.8 përqind. IHD-të në formë të instrumenteve të borxhit shënuan vlerë negative prej 18.8 milionë euro (16.5 milionë euro në periudhën e njëjtë të vitit 2017). Rënia më lartë e IHD-ve u shënuar në sektorin e ndërtimitarisë dhe të shërbimeve financiare (34.1 përkatësisht 12.4 milionë euro) përderisa në patundshmëri dhe në sektorin e tregtisë u shënuar rritje e IHD-ve (12.2 përkatësisht 2.2 milionë euro më shumë krahasuar me periudhën e njëjtë të vitit të kaluar). Sa i përket origjinës së IHD-ve, Gjermania paraqet vendin prej nga kanë ardhur më së shumti IHD deri në maj 2018 (30.1 milionë euro), pasuar nga Zvicra me 26.4 milionë euro, Austria me 13.8 milionë euro, etj.

### **Citimi i sugjeruar i këtij publikimi:**

BQK (2018): Vlerësimi Ekonomik Tremujor Nr. 23 TM2 2018, Banka Qendrore e Republikës së Kosovës, Prishtinë

### **Referencat:**

BQK (2018):

- a) Buletini Mujor Statistikor: <http://bqk-kos.org/?id=97>
- b) Statistikat zyrtare të BQK-së, Seritë kohore: <http://www.bqk-kos.org/?cid=1,124>
- c) Shpalljet dhe Rezultatet e ankandeve për letra me vlerë të qeverisë: <http://bqk-kos.org/?id=107>

ASK (2018):

- a) Indeksi i çmimeve të konsumit: [http://esk.rks-gov.net/publikimet/cat\\_view/98-cmimet/15-indeksi-i-cmimeve-te-konsumit-](http://esk.rks-gov.net/publikimet/cat_view/98-cmimet/15-indeksi-i-cmimeve-te-konsumit-)
- b) Indeksi i çmimeve të prodhimit: [http://esk.rks-gov.net/publikimet/cat\\_view/98-cmimet/79-indeksi-i-cmimeve-te-prodhimit-](http://esk.rks-gov.net/publikimet/cat_view/98-cmimet/79-indeksi-i-cmimeve-te-prodhimit-)
- c) Indeksi i çmimeve të importit: [http://esk.rks-gov.net/publikimet/cat\\_view/98-cmimet/80-indeksi-i-cmimeve-te-importit-](http://esk.rks-gov.net/publikimet/cat_view/98-cmimet/80-indeksi-i-cmimeve-te-importit-)
- d) Reportori Statistikor mbi ndërmarrjet ekonomike: <http://esk.rks-gov.net/regjistri-statistikor-i-bizneseve/publikimet>
- e) Statistikat e tregtisë së jashtme: <http://esk.rks-gov.net/tregtia-e-jashtme/publikimet>

Bloomberg (2018): Metal Prices database.

FAOUN (2018): World Food Prices, Food and Agriculture Organization of United Nations: <http://www.fao.org/worldfoodsituation/foodpricesindex/en/>

Euribor (2018): Euribor Historical Rates:

<http://www.euribor-ebf.eu/euribor-org/euribor-rates.html>

IMF (2018): World Economic Outlook:

<http://www.imf.org/external/pubs/ft/weo/2016/02/weodata/index.aspx>



## Treguesit e zgjedhur makroekonomik

Përshkrimi	TM2 2017	TM2 2018
Sektori real 1/		
Bruto Produkti Vendor (BPV) (në milionë euro)	1,605.1	-
Çmimet e konsumit (mesatarja vjetore)	1.9%	0.7%
Çmimet e konsumit (fondi i periudhës)	1.9%	0.8%
Sektori fiskal 2/		
Të hyrat buxhetore (në milionë euro)	414.6	439.2
Shpenzimet buxhetore (në milionë euro)	417.7	427.7
Bilanci primar (në milionë euro)	-3.1	11.5
Sektori financiar (në milionë euro) 3/		
Asetet e korporatave financiare	5,566.3	6,002.6
prej të cilave: Bankat	3,671.2	3,891.5
Kredi	2,390.5	2,661.3
Depozita	2,887.8	3,085.9
Norma e interesit në kredi, fondi i periudhës	6.8%	6.5%
Norma e interesit në depozita, fondi i periudhës	1.1%	1.2%
Hendeku i normës së interesit	5.7%	5.3%
Sektori i jashtëm*, (në milionë euro) 3/		
Bilanci i pagesave		
Llogaria rrjedhëse dhe kapitale	-198.2	-205.1
prej të cilave: remitencat e pranuar	125.5	137.4
Llogaria financiare	-80.9	-107.8
Investimet e huaj direkte në Kosovë	50.0	45.5
Investimet portfolio, net	13.2	1.3
Investimet tjera, net	-35.2	-101.7
Pozicioni ndërkombëtar i investimeve (PNI), net	-89.6	-111.0
Asetet	4,650.0	4,776.0
Detyrimet	4,739.5	4,887.0
Borxhi i jashtëm, gjithsej	2,075.4	1,998.3
Borxhi i jashtëm privat	1,570.5	1,598.3
Borxhi i jashtëm publik	1,541.8	1,511.6

Burimi:

1/ ASK (2017).

2/ MF (2017).

3/ BQK (2017).

\*Të dhënat për bilancin e pagesave përfshijnë muajt prill dhe maj ndërsa për PNI dhe borxh të jashtëm TM1

